



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



Nr. 05/ 1221 / 2020

Në bazë të nenit 35 pika 1 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, të nenit 5 pika d të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës. Neni 18 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Neni 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ nr 15/2019 të MASHT-it
Drejtoria Komunale e Arsimit Ri shpallë:

K O N K U R S

(Për Drejtor shkolle)

1. Titulli: Drejtor Shkolle

Institucioni: SHFMU "Ilaz Thaçi" Hani i Elezit

Kohëzgjatja e kontratës: me mandat 4 vjeçar me mundësi rizgjedhje (vazhdimi).

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Drejtori i institucionit edukativo-arsimor ka përgjegjësi ekzekutiven menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit duke përfshirë:

- Përgatitjen e planit vjetor të punës, planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës.
- Përdorimi efikas dhe efektiv të sistemit të informativ për menaxhimin e arsimit dhe respektimin e kodeve të ndërlidhura të praktikës, sigurimin e të dhënave të nevojshme gjatë tërë vitit shkollor.
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimeve, vlerësimin e mësimeve, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me mësimeve dhe punëtorët tjerë të arsimit.
- Mbështet dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurikulës.
- Mbështet dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve profesionale dhe bashkëpunëtorëve profesional të institucionit edukativo-arsimor.
- Bashkëpunon me Këshillin Drejtues të Shkollës, Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimtarëve dhe Këshillin e Nxënësve.
- Raporton dy herë në vit para Këshillit Drejtues të Shkollës.
- Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijë/nxënësit, duke përfshirë edhe masa disiplinore ndaj nxënësve.
- Bënë ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave siç parashihet nga Komuna dhe MASHT-i.
- Çështje tjera që rregullohen përmes ligjit dhe obligimet që dalin nga rregullorja e Komunës për Arsim sipas niveleve përkatëse arsimore.

Vlerësimi i performancës së drejtorit do të bëhet me Udhëzim Administrativ përkatës bazuar në standardet e praktikës profesionale të drejtorëve.

Periudha kohore e kontratës zgjatë katër (4) vite. Kandidatët e zgjedhur për drejtor mund të vazhdojnë kontratën në të njëjtin institucion pa konkurs publik në bazë të rezultateve të vlerësimit të performancës që është rregulluar me akt të veçantë nënligjor, bazuar në Ligjin për Inspektoratin e Arsimit në republikën e Kosovës.

Kushtet e pjesëmarrjes në Konkurs:

Kandidatët e interesuar për të konkurruar për pozitën e Drejtorit të shkollës duhet të plotësojnë këto kushte:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës.
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit:

- Master për udhëheqje administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimi prej 330 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar).
- Master arsimor, kualifikimi 300 ECTS 5 vite shkollim universitar.
- Fakulteti katërvjeçar 240 ECTS 4 vite shkollim universitar.
- Bachelor katërvjeçar 240 ECTS shkollim universitar.
- Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve.
- Të ketë të përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim të aprovuar nga MASHT sipas rekomandimit të KSHLM.
- Të ketë përvojë pune në procesin edukativo-arsimor sipas Udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës. Katër (4) vite .

Dokumentet e nevojshme për të konkurruar:

- Kërkesën formulari i aplikimit i plotësuar (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë).
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë).
- Çertifikata e lindjes.
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat) të noterizuara (Master dhe Bachelor).
- Biografi (CV)
- Licencën e mësimdhënësit (ose dëshmi që është në proces të marrjes së licencës).
- Çertifikata shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore.
- Dëshminë që nuk është nën hetime dhe dëshminë që nuk ka qenë i/e dënuar për krim dhunë ose vepra denja që përfshinë fëmijët.
- Dëshminë për përvojën e punës në institucion edukativo-arsimor.
- Letër reference me përmbajtje dëshmuuese për punë dhe angazhim paraprak nga një institucion publik kredibil ((MASHT, DKA, Këshilli Drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë dhe individë me të cilët ka punuar ngusht në programe për arsim).
- Letër motivuese për vendin e punës për të cilin aplikon.
- Koncept planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor për të cilin ka konkurruar, koncepti duhet të bazohet në fushat e cilësisë në arsim dhe të ketë 5 deri 10 faqe tekst (një faqe për një fushë) në hapësirë 1.5 font i shkronjave 12 arial. Koncepti dorëzohet si pjesë e portofolios, por është edhe pjesë kryesore e intervistës.
- Protokollin profesional (shif shtojcën G).
- Dëshmi që andidati/ja për drejtor nuk mbanë funksion udhëheqës politik gjatë tri (3) viteve para aplikimit.

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara sipas **Udhëzimit Administrative 15/2019** si dhe akteve juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (të theksuara më lartë).

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në Komunë përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, në objektin e Komunës së Hani të Elezit.

Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (07) ditë kalendarik, nga dita e publikimit, respektivisht prej datës **20.02.2020 deri më 05.03.2020**

Publikimi bëhet në tabelën e shpalljeve, Web faqe të Komunës dhe në gazetë ditore.

Data: 19.02.2020

